

LIGJ
Nr.8281, datë 21.1.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7804, DATË 10.3.1994 “PËR DHOMAT E TREGTISË
DHE TË INDUSTRIKË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7869, DATË 12.10.1994**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 “Për dhomat e Tregtisë dhe të Industrisë”, ndryshuar me ligjin nr.7869, datë 12.10.1994, neni 12 ndryshohet si vijon:

“Është në kompetencën e dhomave lëshimi i certifikatës jopreferenciale të origjinës për mallrat shqiptare të eksportit dhe i dëshmive të tjera që kërkohen në shkëmbimet ekonomike brenda e jashtë vendit, me përjashtim të rastit kur ligji ua atribuon këto shërbime organeve të tjera.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon certifikatën preferenciale të origjinës së mallrave shqiptare të eksportit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe dhomat e tregtisë përmbushin të gjitha detyrimet kombëtare e ndërkombëtare që rrjedhin nga kjo kompetencë.

Dhomave u ndalohet të marrin përsipër mbrojtjen e interesave në fushën e politikave sociale dhe të legjislationit të punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1995, datë 27.1.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani